

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Mr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Isa Shala e Gani Avdiu anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit Sh.B. nga fshati ... – Malishevë, të cilin e përfaqëson B.Xh. avokate nga Malisheva, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, C.nr. 185/07 të dt. 19.06.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 26.02.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditurës Kompania e Sigurimeve “NN” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, C.nr. 185/07 të dt. 19.06.2013, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Rrethanat e çështjes:

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar është aprovuar në tërësi kërkesëpapia e paditësit Sh.B. nga fshati ... Komuna e Malishevës. Në pikën II., të dispozitivit është obliguar e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” që paditësit t’ia kompensoj dëmin material në shumën prej 380€, për dëmin e shkaktuar ndaj automjetit të tipit “Ford” me nr. të regjistrimit xxx në pronësi të paditësit, në aksidentin e trafikut me datën 01.12.2006, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pikën III., të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t’i kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 403€, dhe atë shumën prej 303€ për përfaqësim të paditësit nga ana e të autorizuarit të saj dhe shumën prej 100€ për ekspertizën e ekspertit të komunikacionit në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta prish Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë C.nr.185/2007 i datës 19.06.2013 dhe çështja të kthehet në rigjykim, apo të ndryshohet aktgjykimi dhe gjykata e shkallës së dytë të vendos vetë lidhur me kërkesëpadinë.

Pala e paditur nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me dëmin e pësuar në automjet si pasojë e aksidentit i cili ka ndodhur me datën 01.12.2006. Gjykata e shkallës së parë në procedurën e zhvilluar pas kryerjes së ekspertimit lidhur me përgjegjësinë e të siguruarit të të paditurës ka gjetur se nuk ka kontestime ndërmjet palëve lidhur me bazën e përgjegjësisë dhe të vetë padisë së parashtruar. Kontestuese ndërmjet palëve ka mbetur lartësia e dëmit të shkaktuar, të cilën lartësi gjykata e ka vendosur në shumën prej 380€ dhe për këtë shumë ka detyruar të paditurën që të bëjë kompensimin e të njëjtës. Gjykata ka vendosur njëkohësisht edhe për shpenzimet e procedurës në lartësi prej 403€, shpenzime këto që kanë lindur si pasojë e zhvillimit të procedurës kontestimore.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji".

Neni 195.1 i LPK: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur".

Neni 491.1 i LPK: "Aktgjykimi ose aktvendimi me të cilin përfundohet procedura e zgjidhjes së kontestit me vlerë të vogël mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale".

Neni 319.1 i LPK: "Secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta".

Vlerësimi i Gjykatës:

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe ky kolegji, për arsye se aktgjykimin i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se me rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës

materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Sipas vlerësimit të kolegjit gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet.

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të palës paditëse lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, janë të pa themelta. Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se natyra e kontestit të zhvilluar në procedurën para Gjykatës Themelore përbënë kontest të vlerës së vogël dhe bazuar në nenin 491.1 të LPK, aktgjykimi i nxjerrë në këtë procedurë mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të të drejtës materiale.

Kolegji vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruara nga ana e paditëses me ankesë se gjykata ka bërë shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Bazuar në nenin 319.1 i LPK-së, secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Pala e paditur në procedurën e zhvilluar nuk ka arritur të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe ankesa e parashtruar për këtë çështje, është vlerësuar si e pa themeltë dhe për këtë gjë edhe është refuzuar si e pa bazuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 3922/13, me dt. 26.02.2016

Kryetari i kolegjit-gjykatësi,
Mr.sc. Rafet Haxhaj